

V E N D I M
Nr.120, datë 6.3.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.599, DATË 20.12.1994 "PËR FUSHAT DHE PROJEKTET PËRPARËSORE PËR T'U FINANCUAR NGA FONDET IDA TË BANKËS BOTËRORE PËR VITET 1995-1997"

Me propozimin e ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.599, datë 20.12.1994 bëhen këto ndryshime:

Pika 1 e aneksit që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, ndryshohet si vijon:

1. Ministria e Financave ngarkohet:

1.1. Të shmangë pengesat që vijnë nga zbatimi i një praktike të re pune nëpërmjet (i) takimeve me njësitë e zbatimit të projekteve për t'i familiarizuar këto me procedurën praktike të skemës së monitorimit nga Thesari dhe për të zgjedhur opsionin më të përshtatshëm dhe (ii) bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë për të mënjanuar problemet e mundshme.

1.2. Të krijojë komisionin e prokurimit për caktimin e kontrollorit të pavarur, i cili do të bëjë kontrollin financiar të të gjitha projekteve në zbatim deri në qershor të vitit 1995. Ky komision të formulojë Termat e Referencës dhe të organizojë procedurën përkatëse brenda një kohe të shkurtër, duke mundësuar kontrollin e një grupi projektesh nga një kontrollor i vetëm. Në përbërje të komisionit të prokurimit mund të caktohen edhe përfaqësues nga njësitë e zbatimit të projekteve dhe institucionet e tjera financiare.

1.3. Të çelen llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë për çdo projekt dhe shumat e arkëtuara në të të përdoren në përputhje me udhëzimet e lëshuara për këtë qëllim.

1.4. Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.511, datë 26.10.1993, të hartojë metodikën për skemën financiare të kthimit të fondit kundërparti nga shitja e importeve kritike.

1.5. Brenda muajit prill të vitit 1995, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, të përcaktohet lista e stoqeve të mbetura nga projekti i importeve kritike dhe afatet e skadimit të tyre për të parë mundësitë e eliminimit.

1.6. Për fondet e kredive të marra nga Banka Botërore që përdoren nga institucione të treta, Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministrinë sektoriale, të lidhin aktmarëveshjet e kredisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi